

Jumpina është një ofertë për këshillim e Qytetit të Winterthur-it për vajzat me vendbanim në Qytet. Oferta është pa pagesë

Kush vjen në jumpina?

- Vajzat mes moshës 13 dhe 18 vjeç
- që janë në kalim nga jeta shkollore në atë profesionale dhe të të rriturve

Pse shkojnë vajzat në jumpina?

- sepse kanë sfida në shkollë apo në kohën e lirë
- sepse ju duhet përkrahje për të gjetur një vend për mësimin e zanatit apo ndonjë mundësi për kyçje të mëtejme
- sepse kanë konflikte me bashkëmohatarët dhe me të rriturit.
- sepse ju duhet përcjellje në krizat dhe vështirësitë që kalojnë në momentin aktual jetësor.

Jumpina do të arrijë qëllimet e mëposhtme

- Të rejat të mund ta vazhdojnë mësimin në shkollë dhe të arrijnë një përfundim të rregullt të shkollimit
- Të rejat/ të rinjtë të gjejnë në vend për mësimin e zanatit apo ndonjë zgjidhje tjetër ndërlihdhëse.

Jumpina mund të ofrojë si vijon

- Përpunimin e përbashkët të hapave të zgjidhjes
- Përkrahje në gjetjen e profesionit dhe në kërkimin e vend-zanatit
- Përkrahje në gjetjen e një zgjidhjeje ndërlihdhëse, si për shembull «Viti parapërgatitor për profesion»
- Ndërmjetësim dhe këshillim në rast të konflikteve
- Përcjellje të natyrës së punës sociale në raste të vështira

- Përkrahje në rast të sfidave të përditshmërisë shkollore
- Këshillimi bëhet në kuadrin e 1 deri 2 terminëve në javë dhe atë gjatë një harku kohor prej të paktën 3 muajve. Një termin zgjat çdo herë nga një orë
- Përveç këshillimit, jumpina ofron çdo të mërkurë tryezën e drekës

Jumpina vlerëson

- kontaktin në besim të plotë me vajzat si bazament të bashkëpunimit
- shikimin e tërësishëm të gjendjes së vajzave, do me thënë ne punojmë me vajzat duke marrë parasysh anët e tyre të forta për arritjen e qëllimeve të tyre.
- Bashkëpunimin e mirë në mes të gjithë pjesëmarrësve profesionalë (shkollës, autoriteteve, institucioneve etj.)
- bashkëpunimin e vyeshëm me prindërit, që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vajzave të tyre.
- trajtimin në besim të plotë të informacioneve

Lajmërimi

- Vajzat dhe prindërit mund të lajmërohen drejtpërsëdrejti te ne.
- Vajzat mund të udhëzohen apo të lajmërohen për bisedë të parë tek ne edhe nga shkolla (mësuesit, punëtorët socialë të shkollave, drejtuesit e shkollave etj.) apo edhe nga entet dhe autoritetet e tjera.
- Pas vendosjes së kontaktit, caktohet edhe një bisedë e parë jo obliguese në kuptimin e arritjes së ndonjë marrëveshjeje. Pas kësaj të rejat dhe ekipi i jumpina-s vendosin për të filluar bashkëpunimin apo jo.

Kontakt

Jumpina

Beratungsangebot für Mädchen
Trollstrasse 18
8400 Winterthur

Telefon: 052 267 65 88

E-Mail: jumpina@win.ch

Homepage: www.stadt.winterthur.ch/jumpina

Erreichbar: Montag – Freitag

Stadt Winterthur 



jumpina

Beratungsangebot
für 13-18jährige
Mädchen zwischen
Schule, Beruf und
Freizeit